

## Skender (Jahë) Kastrati

(28.01.1964, shqiptar nga Malësia e Vogël/  
Radošte, komuna e Rahovecit/Orahovac, bujk,  
tre fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Skenderin e kanë arrestuar më **26.08.1998** në afërsi të fshatit Bellacërkë/Bela Crkva, përdërisa po kthehej nga kufiri, ku ishte në përcjellje të grupit të ushtarëve të UÇK-së, që shkuan në Shqipëri për tu furnizuar me armatime. Po atë ditë, familjarët dëgjuan se policia e ka arrestuar Skenderin te **Bellacërka/Bela Crkva**. Dy ditë më vonë [28.08.1998], banorë të Bellacërkes/Bela Crkva e kanë gjetur trupin e pajetë të Skenderit në një fushë pranë fshatit. Po atë ditë, e kanë varrosur në varrezat e fshatit. Në datën 22.07.1999, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Skenderit në varrezat e fshatit të lindjes së Malësisë së Vogël/Radošte.

**Burimet:** deklarata N. K, FDH-14496; deklarata F.Z, FDH-12323; deklarata N.K, FDH-3590; J.Martinsen, *Registri...*, FDH-26092.

## Shemsije (Qazim Berisha) Hoti

(25.05.1954, shqiptare nga Pataçani i Poshtëm/  
Donje Potočane, komuna e Rahovecit/  
Orahovac, amvise, katër fëmijë)

## Sutki (Sadik) Hoti

(11.08.1985, shqiptar nga Pataçani i Poshtëm/  
Donje Potočane, komuna e Rahovecit/  
Orahovac, nxënës)

Banorët e Pataçanit të Poshtëm/Donje Potočane, në mesin e të cilëve edhe Shemsija me familjarët e, disa herë e kishin braktisur fshatin për shkak të sulmeve të forcave serbe. U strehoheshin në pyllin e afërt. Kur situata qetësohej, ata u riktheheshin në shtëpitë e veta. Në datën **3.09.1998**, nga ora 7:00, forcat serbe e filluan bombardimin e serishëm të **Pataçanit të Poshtëm/Donje Potočane**. E tërë familja Hoti rastisi të ishte në shtëpi. Menjëherë filluan të përgatiteshin për arratisje nga fshati. Traktori i tyre ishte jashtë oborrit. Në çastin kur Shemsija dhe Sutkiu po kalonin përmes oborrit me qëllim që të shkonin deri te traktori, një predhë ka eksploduar afër tyre duke i lënë që të dy të vdekur në vend. Në të njëjtën mbrëmje, bashkëshorti i Shemsijes i ka varrosur bashkëshorten

dhe të birin në oborr. Pas përfundimit të luftës, në muajin shtator të vitit 1999, ai i ka rivarrosur mbetjet e tyre mortore në varrezat e Pataçanit të Poshtëm/Donje Potočane.

**Burimet:** deklarata S.H, FDH-15938; deklarata S.H, FDH-2088; deklarata K.Z, FDH-2085; fotografi, FDH-18806; FDH, *Që njerëzit ti mbajnë në mend njerëz*, pyetësor, FDH-26205.

## Sejdi (Miftar) Zyberaj

(1933, shqiptar nga Drenoci/Drenovac, komuna e Rahovecit/Orahovac, bujk, shtatë fëmijë)

Sejdiu ka gjetur vdekjen më **3.09.1998**, kur forcat serbe e bombarduan **Drenocin/Drenovac**. Ka qenë duke ndenjtur vetëm në shtëpi. Familjarët e tij e kishin braktisur më herët fshatin. Mbjetet mortore të Sejdiut u zbuluan në shtëpinë e djegur. E kanë varrosur në varrezat e Drenocit/Drenovac më 5.09.1998.

**Burimi:** deklarata S.Z, FDH-15492.

## Beqë (Athem) Krasniqi

(1923, shqiptar nga Pastasella/Pusto Selo, komuna e Rahovecit/Orahovac, bujk, tre fëmijë)

Forcat serbe e bombarduan fshatin Pastasell/Pusto Selo më **3.09.1998**. Banorët i braktisën shtëpitë e veta dhe u strehuan në pyjet përreth fshatit. Beqa me familjarët e vet u strehuan në vendin e quajtur *Lugu i Pipave/Dolina Pupojaka*, që gjendet në drejtim të Koznikut/Koznik. Në të njëjtën mbrëmje, ai u kthye në **Pastasell/Pusto Selo** për ta kontrolluar shtëpinë. Familjarëve u tha se nuk do të vonohej shumë dhe se do të kthehej menjëherë. Nuk u kthye atë mbrëmje. Ditën e nesërme, pasi forcat serbe e braktisën fshatin, familjarët e Beqës u kthyen në shtëpi. Një ditë më vonë, më 5.09.1998, bashkëshortja e Beqës e ka gjetur trupin e tij në bunarin, i cili gjendej në oborrin e shtëpisë familjare. Në trupin e tij shihej se ishte qëlluar dhe vrrarë me mjete të rënda dhe teh të çmprehur. Po atë ditë, familjarët e kanë varrosur Beqën në varrezat e Pastasellës/Pusto Selo.

**Burimet:** deklarata M.K, FDH-17944; J. Martinsen, *DodsbrÖnnene...*, 50; *Bodies of Killed Albanians Scattered about in Rahovec Villages*,